



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1490/4 Prot.

Vlorë, më 03.11.2016

Vendim
Nr. 63, datë 03.11.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË SENATIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Mbështetur në pikën 3, neni 33, shkronjën d të pikës 1, neni 38 si dhe në zbatim të nenit 132 në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 03.11.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë projektregulloren e Senatit Akademik, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë me ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në nenin 12 pas fjalisë "Çdo kërkesë për futjen në rend të ditës të çështjeve të tjera duhet t'i paraqitet kryetarit të paktën 3 (tre) ditë përpara mbledhjes." të shtohet "Refuzimi i kërkesës në çdo rast të jetë i argumentuar".
- b) Në nenin 13 fraza "Njoftimi për datën dhe rendin e ditës u bëhet me shkrim ..." ndryshon në "Njoftimi për datën dhe rendin e ditës u bëhet në formë të shkruar ose elektronike ...", kurse fraza "...duhet të firmosin për marrjen e njoftimit..." ndryshon në "...duhet të konfirmojnë marrjen e njoftimit, pjesëmarrjen ose japin arsyen në rast mospjesëmarrje...".
- c) Paragrafi i tretë në nenin 14 hiqet.
- d) Në nenin 23 pas frazës "...për tre herë radhazi..." shtohet fraza "...në mbledhjen e muajit...".
- e) Në nenin 24 fraza "...deri në pesë minuta..." ndryshon në "...deri në tre minuta...".
- f) Në nenin 25 tek paragrafi i fundit të shtohet "Shifrat dhe skemat të shoqërohen me material shpjegues i parë paraprakisht nga komisionet përkatëse".



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
-

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE E SENATIT AKADEMIK

Në bazë të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", dhe Statutit të Universitetit "IsmailQemali", Vlorë, Senati Akademik i UV-së, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2016 miratoi Rregulloren e Senatit Akademik si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Senati Akademik i UV-së është organ kolegjal drejtues i këtij Universiteti. Kryetar i Senatit Akademik është Rektori i Universitetit "IsmailQemali", Vlorë.

Neni 2


Senati kryen funksionet në përputhje me nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në përputhje me Statutin e Universitetit dhe në bazë të kësaj rregulloreje, e cila miratohet nga Senati Akademik.

Neni 3

Senati në mbledhjet e tij shqyrton probleme të rëndësishme, që kanë të bëjnë me aktivitetin akademik, shkencor, administrativ, organizativ dhe financiar të Universitetit. Senati Akademik mban qëndrim ndaj çdo problemi të shqyrtuar nëpërmjet vendimeve që merr.

Neni 4

Format e shprehjes së vullnetit të Senatit Akademik janë mirëkuptimi dhe votimi i hapur. Në raste të veçanta votimi bëhet i fshehtë. E drejta e votës ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk është e delegueshme.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 5

Vendimet e Senatit akademik janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë personat e ngarkuar për zbatim.

II. MBLEDHJA E SENATIT AKADEMIK

Neni 6

Senati Akademik i UV-së mbledhet me nismën e kryetarit të tij. Ai zhvillon 1 (një) mbledhje të detyrueshme në muaj por mund të zhvillojë edhe më shumë në përputhje me rregulloren e senatit akademik.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i Senatit Akademik. Në rast mungese, për arsye objektive, të kryetarit të Senatit Akademik mbledhja thirret dhe drejtohet nga nënkryetari. Në rast mungese edhe të këtij të fundit, për arsye objektive, mbledhjen e thërret dhe e drejton njëri nga anëtarët e Senatit Akademik, i deleguar me shkrim prej kryetarit. Si rregull seancat e Senatit Akademik nuk janë të hapura. Përfshihen rastet, kur është e nevojshme të ftohen të huaj, personel akademik, ndihmësakademik apo personel administrativ që ndihmojnë në trajtimin e çështjeve të veçanta.

Neni 7

Senati Akademik mund të thirret në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Kërkesa i drejtohet me shkrim kryetarit, ku paraqitet në mënyrë të përmbledhur çështja që propozohet të diskutohet. Kjo mbledhje mund të zhvillohet në afatin më të afërt të mundshëm.

Neni 8

Në mbledhjen e parë të mandatit të ri njëri nga anëtarët e senatit zgjidhet nënkryetar i Senatit Akademik. Në këtë mbledhje zgjidhen edhe komisionet e përhershme të Senatit Akademik, që mbulojnë nga afër aktivitetin akademik, kërkimin shkencor, veprimtarinë financiare, marrëdhëniet me jashtë, etj. Si rregull të gjithë anëtarët janë të përfshirë në komisionet e përhershme të Senatit Akademik. Komisionet





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

e përkohshme që krijohen sa herë që lind nevoja, mund të konsultohen edhe me specialistë të tjerë jashtë Senatit, të cilët nuk kanë të drejtë vote.

Neni 9

Në mbledhjen e parë të mandatit të ri Senati Akademik shqyrton plotësimin e numrit të vendeve dhe lihen detyrat përkatëse që deri në mbledhjen e radhës vendet të jenë të plotësuara në përputhje me Statutin dhe me Rregulloren e zgjedhjeve të UV-së.

Neni 10

Organizimi i mbledhjeve të Senatit Akademik bëhet nga sekretariati i tij, i përbërë nga një sekretar administrativ (anëtar i senatit akademik) që zgjidhet nga Senati Akademik dhe një sekretar teknik (si rregull sekretari i Rektorit) i caktuar në këtë detyrë nga Rektori.

Neni 11

Data e mbledhjes dhe lajmërimi i anëtarëve caktohen nga kryetari. Data e mbledhjes si dhe dosja me materialet e rendit të ditës vihen në dispozicion të anëtarëve të Senatit Akademik të paktën një ditë para ditës së mbledhjes. Bëjnë përjashtime rastet urgjente kur nuk pret koha për zbatimin e procedurës sipas këtij rregulli.

Neni 12

Rendi i ditës i çdo mbledhjeje propozohet nga kryetari dhe miratohet në fillim të mbledhjes nga Senati Akademik. Çdo kërkesë për futjen në rend të ditës të çështjeve të tjera duhet t'i paraqitet kryetarit të paktën 3 (tre) ditë përpara mbledhjes. Refuzimi i kërkesës në çdo rast të jetë i argumentuar me shkrim. Në raste të veçanta, kryetari mund të propozojë vendosjen në rend të ditës të një çështjeje të paregjistruar më parë. Këtë të drejtë e ka edhe $\frac{1}{4}$ e anëtarëve ose një prej komisioneve të Senatit Akademik.

Neni 13

Njoftimi për datën dhe rendin e ditës u bëhet në formë të shkruar ose elektronike të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik prej sekretarit administrativ, ndërsa anëtarët e Senatit Akademik duhet të konfirmojnë marrjen e njoftimit, pjesëmarrjen ose japin arsyen në rast mospjesëmarrjeje. Për përgatitjen e mbledhjes së ardhshme, anëtarëve të Senatit Akademik u krijohen të gjitha lehtësitë e mundshme.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 14

Mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet kur në të marrin pjesë të paktën 50% + 1 të anëtarëve të tij. Në raste mungesash sekretari administrativ në fillim të mbledhjes dëshmon punën e bërë për njoftimin e anëtarëve që mungojnë. Në rast mosnjoftimi të qëllimshëm personi shkaktar mban përgjegjësi sipas akteve normative në fuqi.

Në rast se nuk plotësohet ky kuorum mbledhja shtyhet për një datë jo më vonë se pas një jave nga mbledhja e mëparshme. Në rast se edhe në mbledhjen e dytë nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm, mbledhja shtyhet për një datë tjetër jo më vonë se pas një jave nga data e caktuar për zhvillimin e mbledhjes së dytë. Në këtë mbledhje të tretë kuorumi vlerësohet i pranueshëm pavarësisht nga numri i anëtarëve.

Neni 15

Procesverbalet e mbledhjeve të Senatit Akademik mbahen nga sekretari administrativ dhe në fund të mbledhjes firmosen nga ai dhe nga kryetari. Zbardhja e procesverbaleve bëhet jo më vonë se 10 ditë pas mbledhjes.

Neni 16

Pas diskutimit të çështjeve të rëndësishme mund të përpilohet një relacion mbi përfundimet e arritura gjatë diskutimit të tyre dhe u dërgohet anëtarëve të Senatit Akademik. Kur këta nuk kanë vërejtje për pasaktësi, brenda 10 ditëve, Rektori ua dërgon këtë relacion për zbatim dekanëve dhe personave të tjerë për zbatim. Në rast vërejtjesh, relacioni miratohet në fillim të seancës pasardhëse.

Neni 17

Anëtarët e Senatit Akademik shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhje në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

III. VENDIMARRJA

Neni 18

Vendimet e Senatit Akademik merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, veç rasteve që parashikohen ndryshe në ligj dhe në aktet normative.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Në rastin e votimeve nominale të kryerjes së procedurave të vlerësimit të personelit ndihmësakademik dhe administrativ vendimet merren me shumicë absolute (50% + 1 e të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik të UV-së).

Neni 19

Procedura më e zakonshme për marrjen e vendimeve është mirëkuptimi dhe votimi i hapur. Votimi i fshehtë është i detyrueshëm vetëm në rastin e votimeve nominale të kryerjes së procedurave të vlerësimit të personelit ndihmësakademik dhe administrativ dhe për çështje të tjera, kur kjo kërkohet nga kryetari ose nga vetë Senati Akademik.

Neni 20

Vendimet e Senatit Akademik të UV-së shprehen me shkrim dhe u dërgohen zëvendësrektorëve, administratorit të UV-së si dhe dekanëve. Vendimet dhe çdo dokument tjetër i miratuar nga Senati Akademik firmosen nga kryetari në emër të Senatit Akademik.

IV. DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 21

Në Senatin Akademik mund të ftohen drejtuesit e njësive bazë apo ndihmëse të UV-së si dhe anëtarët e tyre që mund të sjellin informacione apo vlerësime me interes për çështjet që diskutohen. Ftesa mund të bëhet me nismën e çdo anëtari të Senatit Akademik të miratuar nga kryetari.

Neni 22

Veç komisioneve të përhershme, Senati Akademik i UV-së mund të ngrejë komisione të veçanta, të cilave u cakton detyra për mbledhje e përpunim informacioni, studim të dhënash, propozime konkrete për probleme të veçanta, etj.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 23

Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron kur:

- përmbushet afati i mandatit;
- jep dorëheqjen;
- largohet nga UV;
- dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
- bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht për të kryer detyrat e tij;
- kur nuk merr pjesë për tre herë radhazë në mbledhjen e muajit, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjen e Senatit Akademik;
- vdes.

Vendi i mbetur bosh plotësohet me personin e radhës të renditur në listën përkatëse të kandidatëve sipas votave të marra gjatë votimit për Senatit Akademik ose anëtarit zgjidhet me short në qoftë se kandidatët e renditur kanë numër të barabartë votash. Kur nuk ka kandidatë të tillë, atëherë Rektori thërret zgjedhje për anëtarë të Senatit Akademik në një trupë zgjedhore të UV-së (personel akademik i fakultetit ose studentët me kohë të plotë studimi në universitet) që përfaqësonte anëtarit pararendës.

Neni 24

Në përputhje me temën dhe numrin e çështjeve të rendit të ditës, çdo anëtar i Senatit Akademik ka të drejtën e fjalës deri në 3 (tre) minuta për çdo çështje. Të drejtën për të folur e jep kryetari i seancës sipas radhës së kërkesës. Kryetari ia ndërpret fjalën anëtarit të senatit që diskuton, në rast të mosmarrëveshjeve të ndryshme mes anëtarëve të tjerë. Kur për shkak të këtyre mosmarrëveshjeve mbledhja rrezikon funksionimin normal kryetari i seancës mund të ndërpresë mbledhjen duke njoftuar vijimin pas 30 minutash apo duke e shtyrë atë për një ditë tjetër.

E drejta e posaçme e fjalës i jepet anëtarit të senatit 1-2 minuta edhe në fund të mbledhjes (në çështje të ndryshme), kur gjykohet se gjatë diskutimeve të çështjeve një diskutues është sulmuar pa të drejtë ose i është deformuar ideja.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

E drejta e ndërhyrjes deri në një minutë mund të jepet në fund të çdo çështjeje, kur ajo kërkohet për të bërë vërejtje të karakterit teknik, para se çështja të kalohet në votim.

Çdo kërkesë për tejkallim afatesh të parashikuara më lart duhet të miratohet paraprakisht nga kryetari i seancës. Çdo shkelje e të drejtës së fjalës nga anëtarët ndëshkohet nga kryetari i seancës me qortim, me paralajmërim për përjashtim nga seanca, me përjashtim nga seanca, shoqëruar edhe me prerje të shpërblimit të mbledhjes në masën nga 50%-100%.

Në rastet e shkeljes së rëndë të kodit të etikës (fyerjeve dhe keqsjelljes akademike/universitare) kryetari i senatit ushtron të drejtat e tij si punëdhënës, ndaj anëtarit të senatit që ka kryer këto shkelje, konform përcaktimeve në rregulloren, aktin apo ligjin që parashikon tipologjinë e shkeljes ligjore.

Neni 25

Çështjet e trajtuara me material të shkruar nga një person i vetëm ose nga grupi i punës depozitohen në afatin e duhur dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të Senatit Akademik para mbledhjes. Për efekt kohe apo për urgjencë të çështjes që diskutohet, materiali i shkruar mund të lexohet në mbledhje, jo i plotë por i përmbledhur. Referuesi, pas diskutimeve, ka në dispozicion deri në 5 minuta për të bërë sqarimet apo saktësimet e duhura, veç kohës, që i duhet për përgjigje ndaj pyetjeve të bëra.

Kur diskutohet buxheti apo çështje financiare e administrative që shprehen në shifra e skema, materiali duhet të jetë patjetër i shkruar dhe i disponueshëm për anëtarët e Senatit Akademik. Shifrat dhe skemat të shoqërohen me material shpjegues i parë paraprakisht nga komisionet përkatëse

Miratuar në mbledhjen e datës 03.11.2016

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.

Adresa /Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Faqe 7 nga 7

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

